



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:084970
Datë: 12.09.2024
Numri i dokumentit: 06153758

C.nr.1455/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Baki Shigjeqi, me bashkëpunëtorin profesional A.K. duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.L. me vendbanim në fshatin Lubinje e Epërme, Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim i përfaqëson av. A.A. dhe av. Z.S. që të dy nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 1,439.10 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 12.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses S.L. me vendbanim në fshatin Lubinje e Epërme, Komuna e Prizrenit, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, **DETYROHET** e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 01.12.2020 deri më datë 31.01.2023 apo për 26 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë 421.00 euro, t'ia paguajë shumën prej **1,439.10 euro**, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura, që paditëses, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **124.00 euro**, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja S.L. me vendbanim në fshatin Lubinje e Eperme, Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të saj av. A.A. dhe av. Z.S. që të dy nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me

objekt të kontestit kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), vlera e kontestit 1,439.10 euro

Të autorizuar e paditëses në padi kanë theksuar, se paditësja është në marrëdhënie pune si mësimdhënëse në Shkollën Filllore "Izvor" në Lubinje e Eperme. KK Prizren. Tutje, ka theksuar se duke u bazuar në nenin 7 të Kontratës kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi më 18.04.2017 dhe atë të vitit 2021 e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021, këtu paditësja ka plotësuar kushtet që në bazë të nenit 7 të këtyre kontratave që punëdhënësi Drejtoria Komunale e Arsimit të ia bëjë në kompensimin në bazë të kualifikimit-licencimit, dhe atë paditëses Saliha Limanovic i takon kompensimi mbi bazën e kualifikimit dhe licencimit prej 27% të një page bazë me diplom bachelor dhe atë vetëm për muajin dhjetor 2020 në vlerë 55.35 euro si dhe nga data 01.01.2021 deri me datën 31.03.2022 për 15 muaj i takon kompensimi i takon kompensimi prej 10% në bazë të licencës apo në vlerë prej 631.50 euro, ku e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj në bazë të kontratës kolektive. Paditësja ka parashtruar kërkesë pranë DKA-së në Prizren, me qëllim të kompensimit mbi bazën e kualifikimit dhe licencimit, mirëpo e njëjta e ka refuzuar pranimin e kërkesës, me arsyetim se nuk ka vijë buxhetore.. Bazuar në të lartcekurat, ka kërkuar nga gjykata aprovimin e kërkesëpadisë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore, i ka kërkuar.

Me parashtrësën e datës 29.12.2023, e kanë bërë precizimin e padisë në kuptimin objektiv, ashtu që kanë kërkuar që të obligohet e paditura Komuna e Prizrenit që paditëses Saliha Limanovic në emër të kualifikimit dhe licencimit të ia kompensoj 27% të një page bazë për periudhën 01.12.2020-31.01.2023, apo për 26 muaj, shumën prej 1,439.10 euro (27% e pagës bazë prej 421.00 euro=113.67 euro, të paguar pjesërisht në muaj shumën prej 58.32 euro, e të mbetura obligim për muaj shumën prej 55.35 eurox26 muaj=1,439.10 euro. Shpenzimet e procedurë kontestimore i ka kërkuar dhe të njëjtat i ka specifikuar dhe atë 104.00 euro për përpilimin e padisë dhe 20.00 euro për taksën gjyqësore.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditëses se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës

Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Andaj nga të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore ka kërkuar që paditësja të i paguaj sipas tarifës së OAK-së

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja, është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë ONSS “Izvor” në fshatin Manastirica, Komuna e Prizrenit. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontratat e punës me numër protokolli 175/20 e datës 26.11.2020, me numër protokolli 61/2021-22, e datës 19.10.2021, me numër protokolli 62/2021-,e datës 26.11.2021, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, rezulton se paditësja është e punësuar tek e paditura si mësimdhënëse. Paditësja ka diplomuar me datë 18.09.2019 dhe ka marr titullin profesional bachelor i programit fillor dhe ka licencë të karrierës. Nga vërtetimi me numër të referencës 147-I/2023, e datës 27.12.2023, vërtetohet se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune në ONSS “Svjetlost” në fshatin Manastirica. Komuna e Prizrenit nga data 26.11.2020 deri më 18.10.2021, ndërsa nga vërtetimi me numër 99/7/2023, e datës 19.12.2023, vërtetohet se paditësja është në marrëdhënie pune në ONSS “Izvor” në fshatin Lubinje e Epërme, Komuna e Prizrenit nga data 19.10.2021 deri më 21.01.2023. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Nga kërkesa e datës 08.04.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja S.L. përmes të autorizuarit të saj i është drejtuar të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtorisë Komunale të Arsimit për kompensim mbi bazën e kualifikimit.

Nga përgjigja me numër 1300 i datës 15.04.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, ka refuzuar kërkesën e parashtruar nga paditësja për kompensimin mbi bazën e kualifikimit me arsyetimin se Kontrata Kolektive nuk ka gjetur zbatueshmëri në Ministrinë e Financave, përkatësisht nuk ka vijë buxhetore për kërkesën në fjalë.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “*shkresa të cilën e ka hartuar në*

formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t’ia bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontratat e punës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditëses ia ka paguar shumë prej 58.32 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 2 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumë prej 113.67 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses për çdo muaj t’ia paguaj shumë prej 55.35 euro apo diferencën e mbetur për 26 muaj, nga data 01.12.2020 e deri më datë 31.01.2023, në shumë të përgjithshme prej **1,439.10 euro** ($26 \times 55.35 = 1,439.10 \text{ €}$).

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që “*po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.*

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë

faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritot.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:084970, 12.09.2024

Gjyqtari,

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palët.